Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut

СУДСКИ СОВЕТ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
KËSHILLI GJYQËSOR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Ул. "Македонија"бр.5, 1000 Скопје | тел.02/3218 130 факс.02/3218 131 | contact@ssrm.mk
Rr. "Makedonija" nr.5, 1000 Shkup | tel.02/3218 130 faksi.02/3218 131 | contact@ssrm.mk

Në bazë të nenit 105 paragrafi (1) alinea (1) nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 41 dhe neni 46 paragrafi (1) pika (1) të Ligjit për Gjykatat ("Gazeta Zyrtare e Republika e Maqedonisë" nr.58/06, 35/08, 150/10, 83/18, 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.96/19) dhe neni 47 paragrafi (1), neni 49 dhe neni 50 paragrafi (1) të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.102/19), Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur me datë 10.03.2025 miratoi:

VENDIM PËR ZGJEDHJEN E GJYQTARIT NË GJYKATËN THEMELORE CIVILE SHKUP

Për gjyqtare në Gjykatën Themelore Civile Shkup është zgjedhur:

1.Sanida Jashar- Kandidat i Akademisë për Gjykatës dhe Prokuror Publik;

Ky vendim do të hy në fuqi pas mbarimit të potëfuqishëm të procedurës dhe do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

A R S Y E T I M

Këshillit Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut publikoi shpallje për zgjedhjen e 6 (gjashtë) gjyqtarve në Gjykatën Themelore Civile Shkup ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.27/2025 nga 07.02.2025).

Në shpalljen e publikur për në Gjykatën Themelore Civile Shkup janë paraqitur 27 kandidatë të cilët i kanë plotësuar kushtet e paraparë me ligj.

Procedurën për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore Gostivar, Këshilli e zbatoi në pajtim me Ligjin për gjykata, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rregulloren e punës së Këshillit Gjyqësor të Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Rregullat për renditjen e kandidatëve për gjyqtarë nga Akademia e Gjykatës dhe Prokuror Publikë.

Këshilli zhvilloi test psikologjik për të kontrolluar aftësitë sociale dhe test integriteti për të kontrolluar vlerat etike dhe morale të kandidatëve, test për të kontrolluar njohuritë e punës praktike me kompjuter dhe zhvilloi intervistë me kandidatët.

Këshilli formoi Komision të përbërë nga anëtarë të Këshillit, i cili përpiloi listën e renditjes dhe i dorëzoi Këshillit listën e mëposhtme të renditjes së kandidatëve:

Nr. Rend	Emri	Mbiemri	Viti i përfundimit të AGJPP	Pikat nga Komisioni nga intervista e realizuar	Pikat e arritjeve nga AGJPP	Numri total i pikave	Gjykata për të cilën ka aplikuar	Nacionaliteti
1	Emillia	Borisavleviq Alleksandrovska	16.01.2025	5,6	57,19	62,79	Gjykata Themelore Civile Shkup	Serb
2	Bernica	Rahiq	16.01.2025	5.65	57,12	62,77	Gjykata Themelore Civile Shkup	Boshnjak
3	Senida	Jashar	16.01.2025	5,43	56,63	62,06	Gjykata Themelore Civile Shkup	Shqipëtar
4	Sulejman	Sulejmanovski	16.01.2025	4,95	55,03	59,98	Gjykata Themelore Civile Shkup	Turq
5	Sibell	Sefedinova	16.01.2025	5,08	53,24	58,32	Gjykata Themelore Civile Shkup	Turq
6	Lira	Bojko	16.01.2025	5,27	52,7	57,97	Gjykata Themelore Civile Shkup	Shqipëtar
7	Fatos	Jusufi	16.01.2025	5,12	52,13	57,25	Gjykata Themelore Civile Shkup	Shqipëtar
8	Fitim	Lloga	16.01.2025	4,74	50,48	55,22	Gjykata Themelore Civile Shkup	Shqipëtar

Në përputhje të nenit 23 nga Rregullorja e punës të Këshillit Gjyqësor të RMV-së ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr 74/19, 186/20 dhe 5/23) Këshilli Gjyqësor ka votuar sipas rangë listës.

Kandidati nga ranglista Sanida Jashar, me 13 vota "Për" dhe asnjë "Kundër" mori shumicën e kërkuar të numrit të përgjithshëm të anëtarëve me të drejtë vote. Me 5 vota "për", kandidati mori shumicën e votëve edhe nga pjesëtarët e pranishëm që u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Secili anëtar i Këshillit me të drejtë vote ka dhënë shpjegime për vendimin e tij për zgjedhjen e gjyqtarit siç parashihet në nenin 49 paragrafi (3) të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kandidati Sanida Jashar është kandidat nga gjenerata e 8-të e kandidatëve nga Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, ka diplomuar në "Shën Kirilin dhe Metodi" në Fakultetin Juridik pran Justinijanit të parë, ndërsa provimin e jurisprudencës e ka dhënë më 24.06.2013 ka përvojë pune gjithësej 13 vjet 1 muaj e 6 ditë, gjegjësishtë 11 vjet e 7 muaj e 21 ditë pas dhënies së provimit të jurisprudencës.

Duke marrë parasysh si më sipër, Këshilli e zgjedhi Sanida Jashar për gjyqtare në Gjykatën Themelore Civile Shkup.

KËSHILLI GJYQËSOR I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISE SË VERIUT
Kryetar
M-r Aleksandar Kambovski

Nr.09-708/1
19.03.2025
Shkup